

UÇK-së e kërcënoi se edhe ai do të shkonte “atje” ku ishte Hetemi. Dy javë më vonë, ushtarët e UÇK-së e kanë arrestuar edhe djalin e Hetemit. E kanë çuar në llogorin e **Llapushnikut/Lapušnik**. Hetemi dhe i biri mbaheshin ndaras në burgun e UÇK-së deri më **25 apo 26.07.1998**, kur forcat serbe e nisën një ofensivë të fuqishme kundër forcave të UÇK-së në rajonin e Llapushnikut/Lapušnik. Për këtë arsye, UÇK-ja e ka zbratur burgun. Nga ora 10.00, dy gardianë i morën afro 20 të burgosurish, të cilët mbaheshin në burg, dhe u nisën me ta drejt **Maleve të Berishës/Berishine planine**. Në një fushë, ata i liruan afro 10 persona të burgosur, ndërkaq me Hetemin dhe të arrestuar të tjerë vazhduan më tutje duke hyrë në një pyll. U ndalën te një zabeli, ku pjesëtarë të UÇK-së i rreshtuan të burgosurit dhe shtënë me qëllim pushkatimin e tyre. Djali i Hetemit ia arriti që të ikte me vrap nga vendngjarja. Ai ishte i fundit që e shihte të atin të gjallë. Trupi i Hetemit ende nuk është zbuluar. Në regjistrin e KNKK-së, rasti i tij është i sistemuar në lëndën që e mban numrin rendor BLG-803897-01.

Burimet: deklarata R.R, FDH-20975; deklarata N.N, FDH-23599; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 28.02.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedok%20Ramiz%20Qeriqi%20-%2028.02.2005..pdf>; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 15.11.2004, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20Uvodna%20rec%20Tuzilastva%20-%2015.11.2004..pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [## Hyzri \(Oruq\) Hajrizi](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=-119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(-IT-03-66-); FHP, Haški tribunal, Sudeenje Slobodanu Miloševiću, XVIII, 123; KNKK, Nestale osobe..., FDH-9795.</p>
</div>
<div data-bbox=)

(15.02.1953, shqiptar nga Belinca/Belince, komuna e Shtimes/Štimlje)

Ditën e pacaktuar të muajit qershor të vitit 1998, Hyzriu ishte nisur me kamionin e vet të tipit *TAM* në drejtim të Petrov-

ës/Petrovo, për të blerë qereç nga Qamil Uka. Po atë ditë, ushtarë të UÇK-së e kanë arrestuar Hyzriun. E çuan në kampin e **Llapushnikut/Lapušnik**. Gardianët e kanë rrahur në disa raste. E kanë vrarë në kuadrin e grupit të të burgosurve, i cili u dërgua në **Malet e Berishës/Berishine planine** më **25 apo 26.07.1998**. Mbetjet mortore të Hyzriut u zbuluan në varrezat masive në **Malet e Berishës/Berishine planine**. Obduksioni ka treguar se ai ishte ekzekutuar me një plumb në kokë. Për shkak të vrasjes së Hyzri Hajrizit dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për Krime Luftë në ish Jugosllavi [ICTY] e ka dënuar Haradin Balajn me 13 vjet burgim.

Burimet: deklarata L.H, FDH-34654; ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 07.03.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj%20-%20svedok%20Shukri%20Buja%20-%2027.03.2005..pdf>; transkript, ICTY, IT-03-66-T, (F. Limaj dhe të tjerë), transkript, 25.01.2005, <http://www.hlc-rdc.org/uploads/editor/file/Transkripti/Limaj/Limaj-svedok%20L-96-25.01.2005..pdf>; ICTY, IT-03-66 (F. Limaj dhe të tjerë), aktgjykimi, 30.11.2005, [## Emin \(Idriz\) Emini](http://www.hlc-rdc.org/index.php?lid=sr&show=PravdaReforma&int_cid=-119&cat=Transkripti/Predmet-Limaj-i-drugi-(-IT-03-66-); OMPF, Mbetjet..., FDH-15297; OMPF, Regjistri i konsoliduar..., FDH-32367.</p>
</div>
<div data-bbox=)

(10.04.1953, shqiptar nga Carraleva/Crnoljevo, komuna e Shtimes/Štimlje, bujk)

Emini ka qenë i burgosuri i kampit të UÇK-ë në **Llapushnik/Lapušnik**, ku i ishte nënshtruar rrahjeve brutale dy herë. Nga të rrahurat e rënda, e kishte humbur aftësinë e të folurit dhe një sy. E kanë pushkatuar në **Malet e Berishës/Berishine planine** më **25/26.07.1998**, kur pjesëtarët e UÇK-së i kanë vrarë edhe nëntë të burgosur të tjerë. Mbetjet e tij mortore u zbuluan në vendin e pushkatimit, në muajin gusht të vitit 2001. Patologët ndërkombëtar kanë konstatuar se Emini ishte ekzekutuar me shumë plumba në kokë. Emini u varros në varrezat e Carralevës/Crnoljevo më 3. 6.2008. Për vrasjen e tij dhe tetë të burgosurve të tjerë, Gjykata Ndërkombëtare për